



01Nr. 400/01-14549/26
Kaçanik, 29.06.2026

Në bazë të nenit 40.2 (b) dhe (c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në shqyrtimin e Draftit të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Kaçanikut për vitet 2027-2029, të Qarkores Buxhetore të MF 2027/01, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 qershor 2026 merr këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE (KAB) TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim APROVOHET Draft Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për vitet 2027-2029.
2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për vitet 2027-2029, do të jetë në procedurë të diskutimit publik me qytetarë.
3. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa të zhvilloj procedurën e diskutimit publik me qytetarë dhe me Ekzekutivin e Komunës dhe pas saj, rezultatet e diskutimit publik t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës, me qëllim të finalizimit të Draft Kornizës.
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut 2027-2029, e hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa 01Nr. 400/01-14549/26

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i komunës, , Drejtoria për Buxhet dhe Financa (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit

Selajdin Troni

